REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

SHPALLJE PËR NËPUNËS CIVIL
NGRITJE NË DETYRË
Konkurrim i brendshëm

Kontrolli i Lartë i Shtetit shpall procedurat për plotësimin e **1 (një)** vendi vakant, në pozicionin **"Përgjegjës i Sektorit të Financës –** *diplomuar minimumi në Master Profesional në Shkenca Ekonomike.*

I. Kërkesat e përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:
- të jenë shtetas shqiptar;
- të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ndaj tij/saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit.

II. Kërkesat e veçanta

- 1 (një) vend në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Financës" – *diplomuar minimumi në Master Profesional në Shkenca Ekonomike.*
Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:
- Të jenë diplomuar jo më poshtë se niveli Master Profesional në Shkenca Ekonomike;
- Të kenë përvojë pune në fushën e diplomimit minimumi 3 vjet;
- Të jenë nëpunës civil në kategorinë III-1;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit të Performancës në punë "Mirë" apo "Shumë mirë";
- Të zotërojnë kualifikime që lidhen me fushën profesionale;
- Të kenë aftësi të mira drejtuese, komunikuese dhe bashkëpunuese;
- Të zotërojnë kualifikime që lidhen me fushën profesionale;

Kategoria e pagës për këtë vend pune është II-2.

III. Përshkrimi i punës për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Financës"

Përgjegjësi i Sektorit të Financës në KLSH kryen këto detyra kryesore:
- Organizon, drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Sektorit të Financës dhe përgjigjet për realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave të tij.
- Ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat e Nëpunësit Zbatues, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Bashkërendon procesin e përgatitjes së kërkesave buxhetore, projektbuxhetit dhe dokumenteve të tjera të planifikimit financiar të institucionit, përgatit dokumentacionin financiar përkatës dhe ndjek zbatimin e buxhetit të miratuar gjatë vitit buxhetor.
- Përgatit raportet periodike të monitorimit të buxhetit, analizat dhe informacionet financiare.

- Organizon dhe mbikëqyr mbajtjen e kontabilitetit, regjistrimin e plotë, të saktë dhe në kohë të transaksioneve financiare, si dhe përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
- Siguron dokumentimin e plotë të transaksioneve financiare, ekzistencën dhe ruajtjen e gjurmës së auditimit dhe të dokumentacionit financiar, sipas kërkesave ligjore dhe procedurave të brendshme.
- Ushtron kontrollet që i përkasin funksionit të Nëpunësit Zbatues mbi dokumentacionin financiar dhe siguron që procedurat për angazhimin dhe kryerjen e shpenzimeve të jenë në përputhje me buxhetin e miratuar, legjislacionin financiar dhe procedurat e kontrollit të brendshëm.
- Në ushtrim të funksionit të Nëpunësit Zbatues, pranon ose refuzon dokumentacionin financiar në rastet dhe sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe dokumenton qëndrimin përkatës.
- Organizon dhe monitoron, sipas përgjegjësive të Sektorit të Financës, procesin e inventarizimit periodik të aktiveve dhe pasiveve dhe ndjek pasqyrimin kontabël dhe sistemimin e diferencave të konstatuara, pas miratimit të tyre sipas procedurave ligjore.
- Siguron mbajtjen dhe rakordimin e evidencës kontabël të aktiveve dhe pasiveve të institucionit dhe ushtron përgjegjësitë e strukturës së financës për administrimin financiar të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Organizon dhe mbikëqyr rakordimet periodike me strukturat e Thesarit, Ministrinë e Financave dhe institucionet e tjera kompetente për çështjet financiare dhe kontabël.
- Monitoron detyrimet financiare të institucionit, përfshirë detyrimet ndaj kreditorëve, dhe siguron procedimin e pagesave brenda afateve, në përputhje me fondet e miratuara dhe kërkesat ligjore.
- Organizon evidentimin dhe arkëtimin e të ardhurave dhe të drejtave të arkëtueshme të institucionit dhe ndjek masat administrative për arkëtimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
- Organizon dhe mbikëqyr zbatimin e detyrimeve fiskale, tatimore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të institucionit dhe respektimin e afateve ligjore për deklarimin dhe pagesën e tyre.
- Siguron administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit financiar dhe kontabël të sektorit, në përputhje me legjislacionin për dokumentacionin financiar dhe arkivat.
- Etj.

IV. Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët që shprehin interesin për të aplikuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:
- Kërkesë;
- Jetëshkrimin e përditësuar me të dhëna të plota në Gjuhën Shqipe;
- Fotokopje të noterizuar të diplomës së nivelit Bachelor dhe Master së bashku me listën e notave;
- Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht sipas legjislacionit në fuqi për njehsimin e diplomave;
- Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim për bazën e vlerësuar;
- Fotokopje të letërnjoftimit;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Dokument që vërteton se nuk ka çështje gjyqësore në ngarkim;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Vërtetim për kategorinë që mbajnë në shërbimin civil;
- Vlerësimin e fundit të performancës në punë;
- Vërtetim që nuk kanë masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kritereve të sipërcituara, si trajnimeve, kualifikimeve, arsim shtesë si dhe vlerësime pozitive të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda datës <u>27.11.2026.</u>

Mosparaqitja e të gjithë dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

V. Faza e verifikimit paraprak

Në faqen zyrtare të KLSH-së *www.klsh.org.al* më datë **04.12.2026** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak për kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura të vendit të punës. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email po në të njëjtën ditë. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

VI. Konkurrimi

Kandidatët do të vlerësohen me shkrim mbi njohuritë në lidhje me:
- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligjin nr. 152/2013, "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "*Për rregullat e etikës në administratën publike*";
- Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së;
- Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së;
- Kuadrin rregullativ për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Kuadrin rregullativ për prokurimet publike;
- Kodin Etik të KLSH-së.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen lidhur me:
- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën lidhur me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Kuptueshmërinë e rregullave dhe procedurave të punës në KLSH referuar rregulloreve të sipër cituara;
- Zbatimin e kuadrit rregullativ në funksion të pozicionit në KLSH;
- Eksperiencat e tyre të mëparshme lidhur me pozicionin e punës;
- Vizioni, motivimi dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

VII. Fazat dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do t'i nënshtrohen fazave të vlerësimit si, verifikimi paraprak dhe vlerësimi i kandidatëve. Verifikimi paraprak, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
Vlerësimi i kandidatëve, përfshin:
a) vlerësimi i jetëshkrimit (arsimimi, përvoja, trajnime të lidhura me fushën);
b) vlerësimi me shkrim;
c) intervista e strukturuar me gojë.
Në përfundim të procesit të vlerësimit vetëm kandidatët që do të grumbullojnë mbi 70% të pikëve totale do të shpallen fitues.

VIII. Njoftimi i kandidatëve

Në faqen zyrtare të KLSH-së, *www.klsh.org.al* më datë **04.12.2026** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak, si dhe datat mbi zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civil që plotësojnë kriteret e veçanta të shpallura.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT